

Pyetje të shpeshta për CityFHEPS
(Për banorët e strehëve të Departamentit të Shërbimeve për Personat e Pastrehë
(Department of Homeless Services) ose Administratës së Burimeve Njerëzore
(Human Resources Administration) ose personat e pastrehë në situatë ruge)
(Albanian)

Ky dokument ofron informacion të përgjithshëm rreth programit CityFHEPS. Ky informacion është për familjet që banojnë aktualisht në strehë ose që janë të pastrehë në situatë ruge dhe po aplikojnë për herë të parë për programin CityFHEPS. Nuk ka për qëllim të japë detaje të plota rreth funksionimit të programit CityFHEPS.

Çfarë është CityFHEPS?

CityFHEPS është një program i ndihmës për qiranë, që ndihmon individët dhe familjet të gjejnë strehim dhe ta ruajnë atë. Administrohet nga Departamenti i Shërbimeve Sociale (Department of Social Services, DSS), që përfshin Departamentin e Shërbimeve për Personat e Pastrehë (Department of Homeless Services, DHS) dhe Administratën e Burimeve Njerëzore (Human Resources Administration, HRA).

A mund të përfitoj nga CityFHEPS nëse banoj në një strehë të HRA-së ose DHS-së?

Jo çdo individ apo familje që banon aktualisht në strehë do të përzgjidhet për programin. Nëse po zhvendoseni nga një strehë e DHS-së ose HRA-së, familja juaj nuk duhet të ketë jetuar më parë gjatë vitit të kaluar në banesën ku po zhvendoseni tani.

Për të përfituar CityFHEPS, familja juaj duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- a. Duhet të ketë të ardhura bruto më të ulëta ose të barabarta me 200% të nivelit federal të varfërisë*,
 - b. Të përfitojë nga ndihma ekonomike, nëse plotëson kushtet;
 - c. Të mos kualifikohet për ndonjë program tjetër ndihme për qiranë, duke përfshirë FHEPS-në;
- ★ Nëse jeni një i rritur beqar që përfitoni rrogë minimale dhe punoni të paktën 35 orë në javë, të ardhurat tuaja bruto mund të jenë më të larta se 200% e nivelit federal të varfërisë.

DHE

1. Duhet të përmbushë **një** nga kërkesat e mëposhtme:
 - a. Të jetë familje që jeton në një strehë të DHS-së *; **OSE**
 - b. Të jetë individ i rritur beqar që jeton në një strehë të DHS-së *;
 - c. Të banojë në një strehë të HRA-së *;
 - d. Të banojë në një strehë të DHS-së dhe të jetë i kualifikueshëm për një strehë të HRA-së *;
- ★ Nëse po zhvendoseni nga një strehë e DHS-së ose HRA-së, familja juaj nuk duhet të ketë jetuar më parë gjatë vitit të kaluar në banesën ku po zhvendoseni tani.

DHE

(Ktheni faqen)

2. Duhet **gjithashtu** të përmbushë **një** nga kërkesat shtesë të mëposhtme:

- a. Familja përfshin një të rritur që ka qenë duke punuar (me ose pa subvencion) 10 orë në javë për 30 ditët e fundit;
- b. Një pjesëtar në familje ka aftësi të kufizuara (përfiton nga përfitime federale për aftësi të kufizuara ose nga ndihma ekonomike e vazhdueshme dhe është në programin WeCARE SSI);
- c. Një pjesëtar në familje është 60 vjeç e lart;
- d. Një pjesëtar 18 vjeç e lart përjashtohet nga detyrimet për punë lidhur me ndihmën ekonomike sepse nevojitet në shtëpi për t'u kujdesur për një pjesëtar të familjes me aftësi të kufizuara;
- e. Familja përfshin një person që ka shërbyer në Forcat e Armatosura të SH.B.A-së.
- f. Familja po jeton në një strehë të DHS-së që është duke u mbyllur.
- g. Familja u referua nga një program kualifikimi i CityFHEPS, dhe DSS-ja ka vendosur se CityFHEPS është i nevojshëm për të shkurtuar qëndrimin në strehë. (Nëse jeni në një strehë të DHS-së dhe këto janë të vlefshme për ju, menaxheri i çështjes suaj do të shohë një shënim në dosjen e çështjes suaj).

Nëse po zhvendoseni nga një strehë e DHS-së ose HRA-së, familja juaj nuk duhet të ketë jetuar më parë gjatë vitit të kaluar në banesën ku po zhvendoseni tani. Nëse keni ndonjë pyetje për CityFHEPS dhe kualifikueshmërinë tuaj, duhet të kontaktoni me specialistin për çështjet e strehimit ose me menaxherin e çështjes.

A mund të marr ndihmë për të paguar tarifat e aplikimit për apartamentin tim nëse jetoj në një strehë të DHS-së?

Nëse jetoni në një strehë të DHS-së, ne mund të paguajmë tarifat e aplikimit për apartamentin tuaj. Flisni me menaxherin e çështjes suaj nëse keni nevojë për këtë ndihmë.

A mund të përfitoj nga CityFHEPS nëse jam i pastrehë në situatë rruge?

Nëse jeni i pastrehë në situatë rruge, jeni vendosur në një qendër për të pastrehët, ose po jetoni në rrethana të strehimit të përkohshëm, duhet të përfitoni nga shërbimet e një ofruesi të kontraktuar të DHS-së, në mënyrë që të përzgjidheni për CityFHEPS. Mund të përzgjidheni për CityFHEPS nëse jeni vendosur në strehim të përhershëm pasi jeni zhvendosur nga një qendër për të pastrehët, nga rrethanat e strehimit të përkohshëm, ose direkt nga rruga.

Megjithatë, duhet të plotësoni kriteret bazë të kualifikueshmërisë për CityFHEPS:

1. Duhet të keni të ardhura bruto më të ulëta ose të barabarta me 200% të nivelit federal të varfërisë*,
 2. Të përfitoni nga ndihma ekonomike, nëse plotësoni kushtet;
 3. Të mos kualifikoheni për ndonjë program tjetër ndihme për qiranë;
- ★ Nëse jeni një i rritur beqar që përfitoni rrogë minimale dhe punoni të paktën 35 orë në javë, të ardhurat tuaja bruto mund të jenë më të larta se 200% e nivelit federal të varfërisë.

Nëse keni ndonjë pyetje për CityFHEPS dhe kualifikueshmërinë tuaj, duhet të kontaktoni me specialistin për çështjet e strehimit ose me menaxherin e çështjes.

(Ktheni faqen)

Si do ta di që kualifikohem për CityFHEPS?

Do ta kuptoni nëse mund të kualifikoheni për CityFHEPS kur të merrni letrën e blerjes dhe letrën e pjesës së pagesës së familjes. Këto letra lëshohen nga DSS-ja dhe do t'ju ofrohen nga specialisti i strehimit ose menaxheri i çështjes suaj. Pasi t'i merrni këto letra, mund të filloni të kërkonit për strehim.

Pasi të gjeni strehim, duhet t'i tregoni specialistit të strehimit ose menaxherit të çështjes suaj. Ata do t'ju ndihmojnë të dorëzoni dokumentet e kërkuara në mënyrë që DSS-ja të jetë në gjendje të përcaktojë nëse kualifikoheni për CityFHEPS dhe nëse strehimi juaj kualifikohet për programin.

A duhet të jem përfitues i ndihmës ekonomike për të marrë CityFHEPS?

Nëse familja juaj kualifikohet për ndihmë ekonomike, duhet të jeni duke i marrë ato përfitime. Për më tepër, nuk duhet të keni ndonjë "sanksion" në dosjen tuaj. Një sanksion vendoset kur ju, ose një familjar i juaj, nuk respekton rregullat e HRA-së dhe familja juaj merr më pak përfitime. Nëse ju ose dikush tjetër në familjen tuaj ka një sanksion, duhet të shkoni në Qendrën e Aksesit të Përfitimeve në DSS/HRA për ta hequr përpara se të përfitoni nga CityFHEPS.

Për sa kohë mund të vazhdoj të përfitoj CityFHEPS?

Zakonisht, Programi CityFHEPS mundëson deri në katër rinovime vjetore, me kohëzgjatje shtesë të disponueshme për "shkaqe të forta."

Maksimumi prej pesë vitesh nuk zbatohet për familje që përfshijnë një individ 60 vjeç e lart, ose që përfshijnë një të rritur që merr përfitime nga ndihma federale për aftësi të kufizuara. Rinovimet varen nga vazhdimi i përmbushjes së kriterëve të kualifikueshmërisë nga ana e familjeve dhe vazhdimësia e disponueshmërisë së fondeve.

Çfarë të bëj me letrat për blerjen dhe hisen e familjes?

Pasi të përcaktohet se ju ndoshta kualifikoheni për të marrë CityFHEPS nga DSS-ja, menaxheri i çështjes ose specialisti juaj i strehimit do t'ju japë dy dokumente: letrën e blerjes dhe letrën për pjesën e pagesës së familjes.

Marrja e këtyre letrave nuk do të thotë që ju jeni përfundimisht të kualifikuar për CityFHEPS. Kjo do të thotë vetëm se ka mundësi të kualifikoheni për CityFHEPS. Kualifikueshmëria juaj për programin do të përcaktohet vetëm pasi të keni gjetur një apartament ose njësi me dhomë teke (SRO) që kualifikohet dhe pasi menaxheri i çështjes ose specialisti juaj i strehimit të dorëzojë paketën e dokumenteve të kërkuara te DSS-ja.

Pasi të keni marrë letrën e blerjes dhe letrën për pjesën e pagesës së familjes, shqyrtojini dhe diskutojini ato me menaxherin e çështjes ose specialistin tuaj të strehimit. Nëse informacioni personal dhe i të ardhurave në këto letra është i saktë, menaxheri i çështjes ose specialisti juaj i strehimit do të fillojë t'ju ndihmojë të kërkonit strehim të përhershëm.

Çfarë të bëj me letrën e blerjes dhe letrën për pjesën e pagesës së familjes (vazhdim)?
Është përgjegjësia juaj të kërkonti dhe të gjeni strehim. Kur të kërkonti, duhet të mendoni me kujdes për atë që është më e rëndësishme për ju. Për shembull, mund t'ju duhet të jeni pranë familjes, shkollës, mjekëve, etj.

Si më ndihmojnë këto letra të gjej strehim?

Ndërsa kërkonti strehim dhe flisni me qiradhënësit, letra për blerje do t'ju udhëzojë ju, qiradhënësin tuaj të mundshëm dhe çdo ndërmjetës me të cilin mund të bashkëpunoni.

Letra e blerjes do t'ju tregojë juve, qiradhënësit dhe/ose një ndërmjetësi:

- Shumën më të lartë të qirasë që CityFHEPS do të lejojë për madhësinë e familjes suaj dhe alternativat për llojin e strehimit (pra apartament, dhomë, SRO);
- Disa nga incentivat financiare që DSS-ja mund t'i ofrojë qiradhënësit ose ndërmjetësit; *dhe*
- Llojet e dokumentacionit që nevojiten nga qiradhënësi ose ndërmjetësi për të vazhduar vlerësimin e kualifikueshmërisë për CityFHEPS.

Letra për pjesën e pagesës së familjes është **vetëm për përdorimin tuaj**. Nuk ka për qëllim që të ndahet me qiradhënësit ose agjentët e mundshëm.

Letra për pjesën e pagesës së familjes cilëson:

- Shumën e mundshme të ndihmës financiare për qiranë nga CityFHEPS;
- Pjesën nga shuma e qirasë që mund t'ju duhet të paguani ("pjesa e pagesës së familjes suaj"); *dhe*
- Arsytet që kemi gjetur se pse ju mund të kualifikoheni për të përfituar CityFHEPS.

Kjo letër detajon gjithashtu informacionin e të ardhurave të familjes që DSS-ja ka në dosje për ju dhe/ose familjen tuaj. Është e rëndësishme që ta shqyrtoni këtë informacion për t'u siguruar që është i saktë. Nëse jeni miratuar për CityFHEPS, do të merrni një letër nga DSS-ja me pjesën tuaj përfundimtare të pagesës së familjes. Nëse informacioni juaj ka ndryshuar nga momenti kur keni marrë letrën për pjesën e pagesës së familjes, shuma që letra juaj e miratimit cilëson se do të duhet të paguani mund të jetë e ndryshme. Letra juaj e miratimit specifikon shumën e saktë që duhet të paguani.

Çfarë lloj banese mund të marr me qira duke përdorur CityFHEPS? Ku mund ta përdor CityFHEPS-in tim?

Ju mund ta përdorni CityFHEPS-in për të marrë me qira një apartament të tërë kudo brenda shtetit të Nju-Jorkut. Ju mund të përdorni CityFHEPS për të marrë me qira një apartament ose SRO në pesë (5) lagje të qytetit të Nju-Jorkut. Shumat e qirasë dhe të shërbimeve utilitare të pasqyruara në këtë dokument janë të vlefshme vetëm nëse zhvendoseni brenda qytetit të Nju-Jorkut. Nëse po merrni në konsideratë të zhvendoseni në një apartament jashtë qytetit të Nju-Jorkut, por brenda shtetit të Nju-Jorkut, vizitoni faqen e internetit të DSS CityFHEPS për të zbuluar shumat mbarështetërore në <https://www.nyc.gov/site/hra/help/cityfheps-documents.page>.

Njësitë SRO janë të disponueshme vetëm për familje me një të rritur. Qiraja maksimale që CityFHEPS do të lejojë brenda qytetit të Nju-Jorkut është \$1,985 në muaj.

Një dhomë teke është e disponueshme për një familje me jo më shumë se dy të rritur. Qiraja maksimale që CityFHEPS do të lejojë brenda qytetit të Nju-Jorkut është \$1,100 në muaj.

(Ktheni faqen)

Çfarë lloj banese mund të marr me qira duke përdorur CityFHEPS? Ku mund ta përdor CityFHEPS-in tim (vazhdim)?

Standardet e pagesave janë shuma maksimale e subvencionit që HRA-ja do t'i paguajë pronarit ose qiradhënësit në emër të qiramarrësit CityFHEPS. Standardet e pagesave të HRA-së bazohen te standardi i Seksionit 8 të miratuar nga Autoriteti i Banesave të Qytetit të Nju-Jorkut (New York City Housing Authority, NYCHA).

Këto standarde pagesash ndryshojnë në bazë të numrit të dhomave të gjumit dhe nëse përfshihen të gjitha ose disa shërbime utilitare. Sigurohuni që të dini se cilat shërbime utilitare, nëse ka të tilla, përfshihen në qira. Tabela më poshtë tregon maksimumin që HRA-ja do të paguajë bazuar në numrin e dhomave të gjumit dhe llojet e shërbimeve utilitare që përfshihen në qira, nëse ka.

Standardi i pagesës i referohet edhe numrit maksimal të dhomave të gjumit që HRA-ja do të subvencionojë. Standardet e pagesave bazohen vetëm në numrin e njerëzve që banojnë në familjen e asistuar. HRA-ja do të paguajë për një dhomë gjumi/zonë gjumi për çdo dy persona. Për shembull, nëse janë 3 persona, HRA-ja do të paguajë për një banesë me 2 dhoma gjumi, pasi kjo do të mundësojë fjetjen e 2 personave në një dhomë gjumi dhe të 1 personi në dhomën tjetër.

Shumat në tabelën e mëposhtme janë të vlefshme vetëm nëse zhvendoseni brenda qytetit të Nju-Jorkut. Nëse po merrni në konsideratë të zhvendoseni jashtë qytetit të Nju-Jorkut, por brenda shtetit të Nju-Jorkut, vizitoni faqen e internetit të DSS-së për të zbuluar shumat mbarështetërore në <https://www.nyc.gov/site/hra/help/cityfheps-documents.page>.

Numri i pjesëtarëve të familjes	Numri i dhomave të gjumit	Standardi i pagesës* (Hyn në fuqi më 07.01.2025)
1	SRO	\$1,985
1	Studio	\$2,646
1 ose 2	1	\$2,762
3 ose 4	2	\$3,058
5 ose 6	3	\$3,811
7 ose 8	4	\$4,111
9 ose 10	5	\$4,728
11 ose 12	6	\$5,345
13 ose 14	7	\$5,962
15 ose 16	8	\$6,579
17 ose 18	9	\$7,196
19 ose 20	10	\$7,812

★ Standardet e pagesave në grafikun e mësipërm janë shumat maksimale të qirasë nëse te qiraja janë përfshirë të gjitha shërbimet utilitare.

(Ktheni faqen)

Po sikur të gjej një apartament me më pak dhoma gjumi se sa përcaktohet në letrën time të blerjes?

HRA-ja do ta paguajë standardin bazuar te qiraja aktuale, jo letra e blerjes. Për shembull, nëse letra juaj e blerjes cilëson se mund të merrni me qira një apartament me 3 dhoma gjumi, por ju merrni me qira një apartament me 2 dhoma gjumi, ne do të paguajmë standardin për një apartament me 2 dhoma gjumi. Nëse keni pyetje në lidhje me një banesë specifike që po shikoni ose ndonjë rrethanë të veçantë që mund të hasni, kërkoni menaxherit të çështjes suaj që ta përshpejtojë shqyrtimin e banesës.

Po sikur të gjej një apartament me më shumë dhoma gjumi se sa përcaktohet në letrën time të blerjes?

HRA-ja do ta paguajë standardin bazuar te madhësia maksimale e banesës për familjen tuaj. Për shembull, nëse letra juaj e blerjes cilëson se mund të merrni me qira një apartament me 2 dhoma gjumi, mund të merrni me qira një apartament me 3 dhoma gjumi për sa kohë që arrini standardin e pagesës për një apartament me 2 dhoma gjumi (nëse po zhvendoseni brenda qytetit të Nju-Jorkut, pagesa standarde për një apartament me 2 dhoma gjumi është \$3,058).

Po sikur të gjej një apartament ku shuma është po aq sa do të ishte bashkë me shërbimet utilitare, por shërbimet utilitare nuk janë të përfshira? A mund të bëj një marrëveshje me qiradhënësin për të ulur qiranë dhe unë të paguaj diferencën?

HRA-ja nuk do të paguajë për një apartament nëse nuk ofrohen të gjitha shërbimet nga qiradhënësi. Qiradhënësit duhet të plotësojnë një formular duke i treguar HRA-së se cilat shërbime utilitare ofrohen, nëse ka. Dhe jo, marrëveshjet dytësore me një qiradhënësi nuk lejohen.

A ka DSS-ja ndonjë kërkesë tjetër për apartamentin/njësine?

Po. Në mënyrë të ngjashme me seksionin 8, të gjitha qiratë duhet të kalojnë me sukses testin e vlerësimit të qirasë, që do të thotë se qiraja e përcaktuar nuk mund të jetë më e madhe krahasuar me njësitë e ngjashme të banimit në lagje. Testi i arsyeshmërisë së qirasë do të bëhet pasi të dorëzohen të gjitha dokumentet në DSS.

Si përcaktohet shuma që duhet të paguaj për qiranë?

Shuma që duhet të paguani për qiranë përcaktohet nga një sërë faktorësh. Këto përfshijnë madhësinë e familjes suaj dhe të ardhurat e secilit pjesëtar të familjes.

Si do ta di se sa do t'i paguajë CityFHEPS-i qiradhënësit tim dhe sa do të duhet të paguaj unë?

Nëse jeni miratuar për CityFHEPS, ne do t'ju dërgojmë një njoftim miratimi ku do të detajohen të dhënat për shumën që ne do t'i paguajmë qiradhënësit dhe sa është shuma që duhet të paguani ju.

Si funksionojnë pagesat mujore?

DSS-ja do t'i dorëzojë çdo muaj qiradhënësit tuaj një çek për pjesën tuaj të qirasë së paguar nga CityFHEPS.

Po sikur kontrata ime të cilësojë se e gjithë qiraja duhet të paguhet deri në një datë të caktuar ose se do të ketë tarifa vonese?

Përderisa pagesa bëhet në muajin që duhet paguar qiraja, nuk konsiderohet e vonuar. Një qiradhënës mund të përpiqet ende të vendosë tarifa vonese, por ju nuk mund të dëboheni vetëm për shkak të tarifave të vonesave.

A mund të më çojë qiradhënësi në gjykatë për shkak të tarifave të vonesave?

Qiradhënësi nuk mund t'ju çojë në gjykatën e strehimit vetëm për shkak të tarifave të vonesave. Qiradhënësi nuk mund t'ju çojë as në gjykatën e kompensimeve në shuma të vogla për shkak të tarifave të vonesave të vendosura për pjesën e qirasë së CityFHEPS. Megjithatë, ata mund t'ju çojnë në gjykatën e kompensimeve në shuma të vogla nëse pjesa juaj është paguar me vonesë dhe janë vendosur tarifat e vonesave. Nëse po hasni vështirësi për të paguar pjesën e familjes, kontaktoni "Homebase" për të parë se çfarë ndihme mund të përfitoni. Telefononi në numrin **311** për të gjetur Homebase-in që ndodhet më pranë jush.

A kam të drejtë të qëndroj në të njëjtën njësi strehimi për aq kohë sa përfitoj CityFHEPS?

Në përgjithësi, nëse jetoni në një njësi me qira të rregulluar, mund të qëndroni në njësinë tuaj. Përndryshe, e drejta juaj për të qëndruar në njësinë tuaj bazohet në kushtet e qirasë.

Po sikur të ardhurat e mia të ndryshojnë dhe të mos mundem më që ta paguaj kontributin tim?

Ju mund të paraqisni një kërkesë për ndryshim te HRA-ja, duke bashkëngjitur dokumentacionin tuaj të ri të të ardhurave. Kërkesën për ndryshimin e subvencionit të ndihmës për qiranë CityFHEPS mund ta gjeni në internet te <https://www.nyc.gov/site/hra/help/cityfheps-documents.page>.

Kur mund të rritet qiraja ime?

Nëse jetoni në një apartament me qira të rregulluar, qiraja juaj mund të rritet vetëm sipas shumës së lejuar me ligj. Nëse nuk jeni në një banesë me qira të rregulluar me ligj, qiradhënësi juaj mund ta rrisë qiranë tuaj me rinovimin e qirasë. Ju mund të dorëzoni një kontratë të nënshkruar qiraje me shumën e rritjes së qirasë së bashku me rinovimin ose mund të përdorni kërkesën për ndryshimin e subvencionit të ndihmës për qiranë CityFHEPS që gjendet në internet në <https://www.nyc.gov/site/hra/help/cityfheps-documents.page>.

Po sikur qiradhënësi im të thotë se duhet të paguaj para shtesë?

Qiradhënësi juaj nuk mund t'ju kërkojë të paguani më shumë se shuma që kemi përcaktuar se është pjesa e pagesës së familjes suaj, përveç rastit kur reduktohet ndihma për strehim. Nëse kjo ndodh, ju do të duhet të paguani diferencën. Qiradhënësi nuk mund t'ju kërkojë të paguani një depozitë sigurie sepse DSS-ja i jep atij një kupon garancie. Nëse qiradhënësi ju kërkon të paguani më shumë, ju lutemi tregojini menaxherit të çështjes suaj ose specialistit të strehimit.

Po nëse një qiradhënësi thotë se nuk do të pranojë pagesa nga CityFHEPS?

Qiradhënësit/agjentët nuk mund të refuzojnë t'ju japin banesë me qira sepse ju po përfitoni CityFHEPS. Ky quhet diskriminim për shkak të "burimit të të ardhurave" dhe është e paligjshme në qytetin e Nju-Jorkut. Nëse një qiradhënësi refuzon t'ju japë banesë me qira për shkak se përfitoni CityFHEPS, ju lutemi të telefononi Komisionin për të Drejtat e Njeriut të Qytetit të Nju-Jorkut (NYC Commission on Human Rights) në numrin 212-416-0197.

Kë duhet të telefonoj nëse kam nevojë për ndihmë ose nëse kam pyetje rreth CityFHEPS-it?

Duhet të flisni si fillim me menaxherin e çështjes suaj ose me një specialist strehimi për çdo pyetje që mund të keni.

Çfarë ndodh nëse kam probleme me pagesën e qirasë ose kam ndonjë problem tjetër strehimi pasi të largohem nga streha?

Pasi të largoheni nga streha, nëse jetoni në qytetin e Nju-Jorkut, mund të kontaktoni "Homepage" për çdo shërbim pasues. Kontaktojini ata menjëherë nëse keni probleme me pagesën e qirasë, duke përfshirë çdo rritje të qirasë me rinovimin e qirasë. Telefononi në numrin **311** për të gjetur Homepage-in që ndodhet më pranë jush ose telefononi ofruesin tuaj jorezidencial. Nëse jetoni jashtë qytetit të Nju-Jorkut, por brenda shtetit të Nju-Jorkut, telefononi 718-557-1399.

Ju duhet të dini se

- Një qiradhënës ose ndërmjetës nuk mund të refuzojë të pranojë CityFHEPS. Refuzimi për të pranuar CityFHEPS mund të përbëjë diskriminim për shkak të burimit të të ardhurave sipas ligjit për të drejtat e njeriut në qytetin e Nju-Jorkut, ose ligjit për të drejtat e njeriut në shtetin e Nju-Jorkut.
- Marrëveshjet dytësore janë të ndaluara. Një marrëveshje dytësore është kur një qiradhënës ose ndërmjetës ju kërkon pagesa shtesë paraprake ose të vazhdueshme.
- Nëse një qiradhënës ose ndërmjetës e refuzon CityFHEPS-in ose ju kërkon një marrëveshje dytësore, telefononi Komisionin për të Drejtat e Njeriut të Qytetit të Nju-Jorkut në numrin 212-416-0197.
- Kuponi i garancisë i HRA-së konsiderohet pagesë garancie. Një qiradhënës ose ndërmjetës nuk duhet t'ju kërkojë të paguani para shtesë për garancinë.
- Ndërmjetësit nuk duhet t'ju kërkojnë të paguani ndonjë tarifë shtesë ndërmjetësi sepse këtë tarifë ndërmjetësimi e paguan DSS-ja.
- Qiradhënësi juaj nuk mund t'ju detyrojë që të shpërnguleni në një njësi tjetër.
- Telefononi menjëherë Komisionin për të Drejtat e Njeriut të Qytetit të Nju-Jorkut në numrin 212-416-0197 nëse banesa që keni parë gjatë prezantimit nuk është e njëjta njësi që ju ofrohet në kohën kur zhvendoseni.

Programi CityFHEPS është i ngjashëm me programin federal të seksionit 8 sepse, në varësi të fondeve në dispozicion, ai ofron asistencë, duke përfshirë ndihmën për qiranë në shuma të specifikuara, për qiradhënësit dhe qiramarrësit që duan të krijojnë një marrëdhënie kontraktore qiradhënës-qiramarrës. Çdo marrëdhënie kontraktore do të lidhet vetëm midis qiramarrësit që është pjesë e programit dhe qiradhënësit të secilit qiramarrës që është pjesë e programit.